



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

V E N D I M
Nr. 359 Datë 11.07.2024

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES FITUESE PËR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, VITI AKADEMIK 2023 – 2024, PROFILI NDIHMËS LIGJOR, ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 11.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për ndihmës ligjor, në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja e çështjes znj. Gentiana Muçaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin dhe lejimin e kandidatës për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor;

V Ë R E N:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është candidate për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor dhe është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 157, datë 04.04.2023, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, profili “ndihmës ligjor”, sipas nenit 34, pika 6, nenit 53, pika 4, dhe nenit 55, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si ligji “Për Pushtetin Gjyqësor”) si dhe në kreun V, të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” (referuar në vijim si vendimi 424/2020).

2. Në vijim, kandidatja ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla e Magjistraturës, në listën e renditjes së kandidatëve fitues në Programin e Formimit Fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2023 – 2024.

3. Në funksion të procedurës së verifikimit në kohë të pasurisë dhe figurës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet dhe informacionet e subjekteve publike dhe private që, sipas ligjit, duhet t'i dërgohen Këshillit, sipas Vendimit nr. 473, datë 07.09.2023, u vendos fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat. Në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës, për kandidaten si ndihmëse ligjore znj. {...}, si relatore u caktua znj. Marçela Shehu.

4. Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës; - për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit treditör, kandidatja depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Në vijim, bazuar në pikat 65 dhe 66, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidates, znj. Metushi, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024.

6.1 Brenda afatit treditör, kandidatja depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, si dhe brenda datës 29.09.2023, kishte detyrimin për të dorëzuar të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë, pranë ILDKPKI-së.

7. Me shkresën nr. 4853 prot., datë 20.09.2023, u njoftua Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), për listën e kandidatëve për në programin e formimit fillestar, për të cilët do të kryhej deklarimi i pasurisë.

8. Gjatë procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 67/b, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024, ndër ta edhe për znj. {...}.

8.1 Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b të Kushtetutës, nënseksioni I, Procedura e zgjedhjes së anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. 737 datë 12.12.2023 ka vendosur :

1. *Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Marçela Shehu.*

9.1 Në vijim, Këshilli me vendimin nr. 9 datë 18.01.2024, pas shortit të hedhur, ka vendosur :

2. *Caktimin e znj. Gentiana Muçaj relatore të procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, në vitin akademik 2023-2024, të papërfunduara për shkak të mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Marçela Shehu, si më poshtë:*
 - i. *znj. {...};*

10. Më datë 22.01.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin 424/2020, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për caktimin/ndryshimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

10.1 Brenda afatit treditor, kandidatja znj. {...}, nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT

A. Për verifikimin e pasurisë

11. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, sipas procedurës së përcaktuar në Seksionin B, të kreut VI, të vendimit 424/2020. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten, u kërkuar raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor raportin “*Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe të Interesave Privatë të kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë {...}, për pranimin në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës/Ndihmës Ligjor*”, me nr. 3247/4 prot., datë 05.02.2024.

11.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

11.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti, nga ILDKPKI janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...} dhe personi i lidhur, duke konkluduar se :

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) dokumentacion jo i plotë ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë së bashkëshortit;
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11.3 Bazuar në rezultatet e këtij raporti, në kuadër të verifikimit të mëtejshëm të kriterit të pasurisë, kandidatja znj. {...} u ftua të jepte shpjegime dhe dokumentacion shtesë nëse kishte.

11.3.1 Brenda afati të caktuar, kandidatja më datë 16.02.2024, paraqiti shpjegime dhe dokumentacion mbështetës mbi rezultatet e raportit të ILDKPKI-së, si më lart.

11.4 Në vijim të procedurës së verifikimit të mëtejshëm të kriterit të pasurisë, shpjegimet dhe dokumentacioni mbështetës i depozituar nga kandidatja, iu përcollën ILDKPKI-së me shkresën nr. 4198/61 prot., datë 21.02.2024 nga Këshilli, me qëllim vlerësimin, apo trajtimin e tyre brenda kuadrit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurive të kandidatës, mbi bazën e të cilave të dërgonte një informacion shtesë.

11.4.1 Në vijim dhe në zbatim të kërkesës së Këshillit, më datë 01.03.2024 u depozitua raporti “Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe të Interesave Privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë {...}, për pranimin Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës/profili Ndihmës Ligjor”, me nr. 193/24 prot., datë 28.02.2024, sipas të cilit është konkluduar se :

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) dokumentacion jo i plotë ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë së bashkëshortit;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11.5 Këshilli, pasi ka shqyrtuar aktet e procedurës së verifikimit lidhur me kandidaten për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor, si dhe parashtrimet e depozituara nga kandidatja, vlerësoi se:

Bazuar në raportin e ILDKPKI – së, si dhe në shpjegimet e paraqitura nga kandidatja {...} është konstatuar se burimi i financimit për pasurinë “{...}”, me bashkëpronarë bashkëshortin e kandidates ({...}) dhe vëllain e tij ({...}) është realizuar përgjatë viteve 1993 – 1998. Ndërtimi i pasurisë “{...}”, përgjatë këtyre viteve është realizuar nga vjehri i kandidates ({...}) dhe më pas legalizimi është kryer në vitin 2015 në emër të bashkëshortit të saj dhe vëllait të tij. Me legalizimin e këtij objektit pronarët e pasurisë “{...}” janë vëllezërit {...}{...} (bashkëshorti i kandidates) dhe {...} (kupati i kandidates).

Bazuar në shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga kandidatja {...} konstatohet se : së pari ndërtimi dhe investimi i pasurisë “{...}” është kryer në një kohë kur kandidatja ka qenë minorene dhe ka jetuar në Vlorë, dhe së dyti që në kohën gjatë së cilës është kryer procesi i legalizimit të objektit kandidatja nuk ka pasur asnjë lidhje / raport me bashkëshortin ({...}{...}) dhe familjarët e tij¹.

Nga ana tjetër kandidatja {...} është angazhuar për dorëzimin në ILDKPKI, të dokumentacionit mbi aktivitetin privat dhe burimin e të ardhurave të vjehrit të saj ({...}) Qëndron fakti se dokumentacioni është i paplotë dhe i ruajtur në mënyrë rastësore, pasi vjehri dhe familjaët e tij,

¹ Kandidati {...} deklaroi se ka filluar bashkëjetesën 30 shtator 2016 dhe ka lidhur martesë në datë 31.12.2018

nuk kanë qenë subjekte deklarimi, dhe nuk kanë vlerësuar ruajtjen e akteve provuese për ekzistencën e aktivitetit privat dhe të të ardhurave prej tij².

Pra, diskutimi bëhet për një pasuri që është krijuar dhe legalizuar në një periudhë kohore kur kandidatja {...}, nuk ka pasur asnjë lidhje/raport me bashkëshortin ({...}{...}) dhe familjarët e tij.

Nga sa është paraqitur nga ILDKPKI – ja dhe nga shpjegimet e kandidatës vërehet se problematikat e konstatuara për personat e lidhur, në rastin konkret bashkëshorti dhe vjehri, referohen vetëm për pasuri të krijuara prej tyre, para martesës së kandidatës {...}.

Bazuar në jurisprudencën e KPA³ – së pasaktësitë mbi pasuritë e krijuara në kohë nga personat e lidhur/familjarët para se kandidati të lidhë martesë apo të marrë detyrën përkatëse nuk mund të paraqesin pengesë për kandidatin {...} që të pranohet në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës/profili Ndhmës Ligjor.

Lidhur me burimin e krijimit të kursimeve familjare në shumën rreth 752.000 lekë, kandidatja {...} ka depozituar dokumentacion⁴ shpjegues me të cilin synon të argumentojë dhe provojë mundësinë e krijimit të kësaj shume nga ana e saj dhe e bashkëshortit.

Bazuar në qëndrimet tashmë të konsoliduara, të mbajtura nga institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve⁵, për komponentin e pasurisë, si dhe në mbështetje të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit Këshilli vlerëson se shuma 752.000 lekë nuk paraqet problematikë pasurore për kandidaten {...}.

Sa më lart pasaktësitë mbi pasuritë e krijuara në kohë, nga kandidatja dhe personat e lidhur/familjarët nuk mund të paraqesin pengesë për kandidatin {...} që të pranohet në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës/profili Ndhmës Ligjor.

12. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

² Dokumentacioni i paraqitur në ILDKPKI; Deklarata noteriale datë 15.02.2024, realizuar nga vjehri {...}{...}, pasqyron origjinën e pasurisë dhe kohën e kryerjes së investimeve monetare (vitet 1991 – 1993 – 1998)

³ Vendimi nr. 19 datë 10.06.2022; Vendimi nr.20 datë 03.05.2023

⁴ Vendimin nr.4553, datë 04.09.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative, Tiranë;
Vendimin nr.2484 (2597), datë 01.06.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë;
Prokurën Nr. 2110 Rep., Nr.713 Kol, datë 11.07.2017;
Vendimin Nr. 771/5 Prot., datë 05.02.2018 i Shoqërisë Përmbarimore “Albasse” shpk.
Prokurën Nr. 253 Rep., Nr. 105 Kol, datë 02.02.2018;

⁵ Vendimarrje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaqëm të Apelit,

12.1 Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 63872/1 prot., datë 05.10.2023, kandidatja {...}, sipas të dhënave të sistemit informatik tatimor, nuk ka aktivitet privat të regjistruar në emrin e saj. Kjo shtetase rezulton e regjistruar për përgjegjësinë tatimore DIVA dhe ka depozituar rregullisht deklaratat individuale vjetore të të ardhurave për vitet 2017 – 2022. Ndërsa personi i lidhur, shtetasi {...}{...} rezultoi i regjistruar në organin tatimor si person fizik më datë 06.11.2012, me përgjegjësinë tatimore DIVA.

12.2 Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 15593/1 prot., datë 05.10.2023, për kandidaten {...} dhe personin e lidhur, nga verifikimet në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave të këtij organi, për periudhën Mars 2004 deri në 20.09.2023, nuk rezultoi ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

13. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, u vlerësua se nuk kishte vend për t'i kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë për znj. {...}. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërorë dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "*Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik*" i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

14. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat Këshilli konkludoi se nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit të saj. Konkretisht, rezultoi se:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- d) deklarimi nga kandidatja, i pasurisë, aseteve ose interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B. Për kriterin e figurës

15. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, sipas procedurës së përcaktuar në Seksionin C, të Kreut VI të vendimit 424/2020.

16. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese.

17. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe u verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...}, me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

18. Në kuadër të verifikimit të kriterit të figurës, kandidates {...} iu kërkua dhe u depozitua rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 14.09.2023, formulari i vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, si dhe autorizimi për Këshillin që, në zbatim të pikës 82, të Seksionit C, të Kreut VI, të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

18.1 Në zbatim të Ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, nga ana e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë KLGJ-së, janë kryer verifikimet e thelluara të të dhënave të formularit të vetëdeklarimit për gjendjen gjyqësore dhe gjendjen civile të kandidates. Në vijim të përgjigjeve të shkresave të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme⁶, nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi u kryhen verifikimet e rastit, nuk u konstatuan mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit, duke konkluduar se znj.{...} : *“- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 14.09.2023; formulari është regjistruar me numrin unik 000696; - vetëdeklarimi është publikuar, në faqen zyrtare ëeb të KLGJ-së; - në formular nuk ka deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve parashikuar me ligj; - ka deklaruar në rubrikën gjeneralitete të mëparshme mbiemrin e vajzërisë “{...}”; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore, rezulton e padënuar nga gjykatat penale shqiptare; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes civile, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga*

⁶ Shih shkresën nr. 4847 prot., datë 20.09.2023, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit.

Prokuroria e Përgjithshme”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

19. Prokuroria e Përgjithshme, sipas kërkesës së Këshillit, ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me shkresën (me nr. 1455/14 prot., datë 16.11.2023) e rregjistruar pranë nesh me nr. 4855/1 prot., datë 16.11.2023, përgjigjet zyrtare të 13 (trembëdhjetë) prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve lidhur me verifikimet e kryera, nuk rezultoi që kandidatja {...} të jetë marrë në cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal apo të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mosfilluara, të pushuara dhe të pezulluara.

19.1 Nga informacioni i paraqitur, me shkresën me nr. 12136/1 prot, datë 03.10.2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar⁷, nuk rezultoi që kandidatja të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, ndaj saj të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara.

20. Me shkresën nr. 4859 prot., datë 20.09.2023 Këshilli, ka kërkuar informacion nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe ato të veçanta që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë kryer verifikimet përkatëse duke përcjellë në Këshill, informacionin e kërkuar. Referuar përmbajtjes së 17 (shtatëmbëdhjetë) përgjigjeve zyrtare të gjykatave, lidhur me verifikimet e kryera, nuk rezultoi që kandidatja të jetë marrë në cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal apo të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mosfilluara, të pushuara dhe të pezulluara.

21. Mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor⁸, Byroja Kombëtare e Hetimit, me shkresën nr. 968/1 prot., datë 04.10.2023, ka informuar se nuk rezultojnë të dhëna rreth figurës së kandidates {...}.

⁷ Kthyer në bazë të shkresës/kërkesë për informacion me nr. 4858 prot., datë 20.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁸ Shkresa nr. 4850 prot., datë 20.09.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

22. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat Këshilli konkludoi se nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit të saj. Konkretisht, rezultoi se:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 83, Seksioni C, Kreu VI të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë, bashkëpunëtoare, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të saj, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cenim të besimit publik në sistemin gjyqësor dhe, për rrjedhojë, mbi pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUSIONE

23. Referuar përcaktimeve të Vendimit 424/2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten fituese për ndihmës ligjor, znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

24. Bazuar në sa është parashtruar më lart mbi rezultatet e verifikimit të pasurisë e figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kritere dhe nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates fituese dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 53, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i

ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet kandidates, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR